



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 21.4.7-2014-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË FONDIT TË BASHKUAR PËR**  
**SEKTORIN E ARSIMIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014**

*Auditim në bazë të marrëveshjes me MASHT/FBSA*

**Prishtinë, Prill 2015**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare te Fondit te Bashkuar për Sektorin e Arsimit FBSA në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Z. Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari, i mbështetur nga, Mirlinda Beqiri (Udhëheqës Ekipi), Florë Berisha, dhe Veton Misiri.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	6
2 Pasqyrat Vjetore Financiare.....	6
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	8
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	8
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP.....	11

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Fondi i Përbashkët në Sektorin e Arsimit është një fond i krijuar nga një grup i partnerëve kontribues për zhvillim për të mbështetur planet zhvillimore në sektorin e arsimit. Ky fond është krijuar në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në mes të, Qeverisë së Kosovës ( përfaqësuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Integritimit Evropian) dhe Partnerëve për Zhvillim (Suedisë/SIDA dhe Agjencisë për Zhvillim të Austrisë). Kohëzgjatja e projektit është 2013-2015 dhe ka për qëllim mbështetjen e planit të ndërtimit të kapaciteteve në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Agjencionet e saj qendrore.

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë është përgjegjëse për implementimin e këtij projekti, duke përfshirë edhe raportimin tek komiteti drejtues i projektit. Realizimi i projektit do të asistohet nga partnerët zhvillues nëpërmjet tre këshilltarëve afatgjatë, një i financuar nga GIZ (Gjermani) dhe dy nga Sida (Suedi).

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Fondit të Bashkuar për Sektorin e Arsimit (tutje FBSA) për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja stafin mbështetës të këtij projekti për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorin Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- pajtueshmërinë më kornizën raportuese dhe cilësinë e informatave të shpalosura në Pasqyrat Vjetore Financiare; dhe
- menaxhimin financiar dhe kontrollin.

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm është:

Pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.
---

## **Konkluzioni i përgjithshëm**

Bazuar në pjesët individuale të shpalosura brenda këtij raporti konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

- informatat e shpalosura në Pasqyrat Vjetore Financiare janë të sakta dhe në pajtim me kornizën raportuese; dhe
- menaxhimi financiar dhe kontrollet funksionojnë kryesisht në mënyrë efikase.

Në aspektin e menaxhimit të projektit, vetëm 28% e shpenzimeve të planifikuara janë realizuar. Gjatë planifikimit të projektit nuk ishin parashikuar të gjitha rrethanat që mund të ngadalsonin ecurinë e projektit në fazën e implementimit sidomos, stërzgjatja e procedurave të prokurimit. Andaj këtij aspekti në të ardhmen duhet ti kushtohet vëmendje e veçantë.

## **Përgjigjja e Komitetit Drejtues – auditimi 2014**

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Komiteti drejtues i FBSA.

## 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e projektit MASHT/FBSA të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) në bazë të marrëveshjes është përgjegjëse për kryerjen e auditimit që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

## 2 Pasqyrat Vjetore Financiare

### **Përshkrimi**

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare.

### **Konkluzioni**

Cilësia e informatave të shpalosura në PVF ishte përgjithësisht e mirë, dhe të gjitha kërkesat për raportim ishin plotësuar. Edhe kërkesat tjera për raportim të jashtëm janë plotësuar plotësisht.

## 2.1 Opinioni i Auditimit

### Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale (**SNISA 200/1700 Opinion i Pamodifikuar**).

## 2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

### Përshkrimi

Mënyra e raportimit për programin FBSA rregullohet me marrëveshjen për financim të përbashkët në mbështetje të zhvillimit të arsimit në Kosovë. Sipas kësaj marrëveshje të dhënat financiare do të mbahen në përputhje me rregulloret financiare të Qeverisë së Kosovës. Pasqyrat financiare për Programin FBSA i dorëzohen Komitetit të FBSA jo më vonë se një muaj pas përfundimit të çdo periudhe të raportimit.

Pasqyrat Financiare duhet të përgatitën në përputhje me ligjet dhe rregulloret vendore, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (SNKSP) dhe sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Ne marrim për bazë:

- pajtueshmërinë me legjislacionin e aplikueshëm lokal; dhe
- pajtueshmërinë me marrëveshjen e dakorduar në mes të palëve nënshkruese.

Ne konsiderojmë që regjistrat kontabël dhe raportet financiare janë mbajtur në pajtim të plotë me kërkesat e legjislacionit të aplikueshëm lokal dhe në pajtim me marrëveshjen.

Përveq FBSA PVF-ve i ka përmbushur edhe obligimet e tjera raportuese si:

- të dhënat financiare për Programin janë mbajtur në përputhje me rregulloret financiare të Qeverisë së Kosovës;
- raportet financiare janë dorëzuar në Komitet dy herë në vit brenda periudhës së paraparë; dhe
- është përgatitur plani vjetor i prokurimit si dhe raporti i monitorimit të prokurimit.

### 3 Rekomandimet e vitit paraprak

Programi FBSA është program i sapo formuar dhe auditimi i vitit 2014 është auditimi i parë i këtij programi i bërë nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

### 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

Qasja jonë e auditimit është e fokusuar në kuptimin dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti, për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll. Ne vlerësojmë nëse kontrollet janë dizajnuar mirë, janë implementuar sipas planit apo funksionojnë në mënyrë efektive. Për ta bërë këtë nevojitet vlerësimi i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të paraqitura nga menaxhmenti.

Një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve është duke u zhvilluar. Marrë parasysh që programi është në fazën e hershme të implementimit, kërkohet vëmendje e shtuar e menaxhmentit, sidomos në bartjen e përgjegjësive rreth aktiviteteve të reja.

#### 4.1 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

##### **Përshkrimi**

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për FBSA si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike.

Ky program gjatë vitit 2013 nuk ka realizuar ndonjë shpenzim ndërsa në dhjetor të vitit 2013 nga partnerët e zhvillimit janë alokuar shuma prej 421,282€, shumë kjo e cila është bartur në vitin 2014. Shpenzimi i buxhetit është i lidhur direkt me projektet e poshtëpërmendura të cilat i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme:



**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti i alokuar - 2014	Shpenzimet e buxhetit për 2014	Pjesa e pashpenzuar
Zhvillimi i kapaciteteve për përmirësimin e cilësisë në arsim në Drejtoritë komunale të arsimit (DKA) dhe shkollat	16,000	6,726	9,274
Asistenca Teknike për MASHT	636,739.9	263,295	373,445
Shpenzimet e paparashikuara	150,000	1,177	148,823
Verifikimi i buxhetit/auditimi i AT për MASHT	10,000	0.00	10,000
Kurset e gjuhës angleze	180,000	4,300	175,700
Trajnimet në TI	35,000	99.9	34,900
Procesi i QTS - Rishikimi i Përbashkët Vjetor	19,050	14,723	4,328
Verifikimi i buxhetit/auditimi i FBSA	5,000	0.00	5,000
Balanci i bartur në vitin e ardhshëm	1,051,790	290,322	761,468

Buxheti total për vitin 2014 prej 1,051,790€ përfshinë 421,282€ të bartura nga viti 2013 dhe 630,508€ të cilat janë alokuar gjatë vitit 2014.

### Çështja 1 - Realizimi i ulët i buxhetit - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Realizimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur. Vetëm 28% e shpenzimeve të planifikuara janë realizuar si pasojë e planifikimit të dobët të aktiviteteve dhe burimeve. Fillimisht ishte planifikuar që projekti të filloj në vitin 2013 dhe ishte paraparë të zhvillohet procedurë e kufizuar e prokurimit për “planin për ngritjen e kapaciteteve në MASHT 2013-2015” si nënprojekti kryesor, mirëpo kontrata nuk kishte arrit të nënshkruhet deri në shtator 2014.
- Rreziku** Planifikimi i dobët i aktiviteteve dhe realizimit i ulët i buxhetit do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të parapara.
- Rekomandimi 1** Komiteti drejtues i FBSA duhet të sigurojë përmirësimin e procesit buxhetor duke bërë të mundur edhe rishikimin e planit operativ nëse është e nevojshme. Poashtu ecuria e projektit dhe performanca buxhetore duhet të monitorohen në mënyrë sistematike, si dhe të identifikohen dhe adresohen barrierat që ndikojnë në realizimin e ulët, në mënyrë që të përmirësohet niveli i realizimit të buxhetit.

## 4.2 Shpenzimet

### 4.2.1 Prokurimi

#### **Përshkrimi**

Ne këtë kategori të shpenzimeve janë përfshirë shpenzimet e bëra për mallra dhe shërbime të cilat duhet të kalojnë përmes procedurave të prokurimit. Prokurimi udhëhiqet me ndihmën e një eksperti të jashtëm të caktuar nga partnerët për zhvillim.

Sipas marrëveshjes së Përbashkët Financimi në mbështetje të Zhvillimit të Sektorit të Arsimit në Kosovë, MASHT-i duhet të paraqesë në Komitet një raport të Monitorimit në lidhje me prokurimet dhe hartojë Planin Vjetor për prokurim për vitin e ardhshëm

Për të vlerësuar këtë kategori të shpenzimeve ne kemi testuar një procedurë prokurimi dhe kemi ekzaminuar pesë pagesa me vlerë totale 265,237€.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 4.2.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

#### **Përshkrim**

Shpenzimet tjera janë shpenzime të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit. Ato kanë pjesëmarrje më të vogël në shpenzimet totale. Vlera e shpenzimeve për periudhën e vitit 2014 ishte 25,085€ apo rreth 9% e shpenzimeve totale. Natyra e këtyre shpenzimeve ka të bëjë me shumë me shpenzime për konsulentë, dreka zyrtare si dhe trajnime për stafin e MASHT.

Në këtë fushë nuk kemi identifikuar ndonjë dobësi materiale. Derisa për trajtimin e disa mangësive procedurale të natyrës teknike do të komunikojmë me stafin përgjegjës për financa. Këto mangësi i takojnë procesit të pagesave dhe kanë të bëjnë me vlera të vogla monetare (arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimit dhe faturimi me çmime të ndryshme të artikujve të njëjtë).

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë

---

një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

---